

Sanatoria: legalizimi i punëtorëve të huaj



E RENDESISHME: aplikimi për legalizim zgjat nga data **1 Qershor deri më 15 Gusht**.

KUJDES: nëse dikush përveç punëdhënësit tënd të premtun një leje qëndrimi (*permesso di soggiorno*) në këmbim të parave, **mos prano** por kontakto një shoqatë që ndihmon punëtorët ose një avokat.

Çfarë është legalizimi?

Legalizim nënkupton të bësh të rregullt nga ana ligjore dicka që në këtë moment është e parregullt. Në rastin e të huajve, legalizim nënkupton që një person pa dokumenta të rregullta të marrë një leje qëndrimi (*permesso di soggiorno*) të rregullt.

Ky akt legalizimi quhet dhe “*sanatoria*”.

Sanatoria e miratuar nga Qeveria Italiane nuk është për të gjithë. Më poshtë do të gësh informacionet se kush mund të aplikojë dhe mënyrën se si.

Legalizimi: ligji Maj 2020

Qeveria ka miratuar një masë për të legalizuar punëtorët e huaj. **Kjo masë është VETEM për punëtorët që gjenden në Itali dhe punojnë në sektorët:**

- bujqësi, mbarështim, peshkim dhe të gjitha aktivitetet e lidhura;
- përkujdesje për të moshuarit dhe invalidët;
- punë shtëpiake.

Janë dy raste të ndryshme për të aplikuar për legalizim:

1.PERSONAT ME LEJE QENDRIMI TE SKADUAR NGA 31 TETORI 2019

Personi i huaj me leje qëndrimi (*permesso di soggiorno*) të skaduar nga 31 Tetori 2019 deri sot dhe që ka punuar rregullisht (pra me kontratë) para kësaj date, në sektorët:

- bujqësi, blegtori, peshkim dhe të gjitha aktivitetet e lidhura;
- përkujdesje për të moshuarit dhe invalidët;
- punë shtëpiake

mund të kërkojë fillimisht **një leje qëndrimi të përkohshme (*permesso di soggiorno temporaneo*)**.

Kjo leje zgjat **6 muaj** (vetëm në Itali) dhe i lejon personit që të kërkojë punë gjithmonë në sektorët bujqësi, ndihmës personale dhe punëve shtëpiake, të listuara më lart.

Nëse në këto 6 muaj personi i huaj gjen punë me kontratë në këta sektorë, leja e përkohshme e tij **do të shndërrohet në leje qëndrimi për arsye pune (*permesso di soggiorno per lavoro*)**.

Nëse të duhet të aplikosh për këtë leje të përkohshme (*permesso temporaneo*) duhet:

- Të jesh i pajisur me pashaportë ose një dokument identiteti, si për shëmbull një dokument që vërteton identitetin tënd të lëshuar nga ambasada e vendit të origjinës;
- Të kesh qenë i pranishëm në Itali në datën 8 Mars 2020, pa u larguar kurrë nga Italia nga data 8 Mars deri sot;
- Të paraqisësh disa dokumenta, siç është kontrata e vjetër e punës, për të treguar se ke punuar para 31 tetorit 2019.

E RENDSISHME: nëse në 6 muaj gjen një punë në një sektorë tjerë, siç është sektori i ndërtimit apo restorantit, leja e përkohshme NUK do të shndërrohet në leje pune.

Si të aplikosh:

Sigurohu më parë të përmbushësh TE GJITHA kushtet për të kërkuar një leje qëndrimi të përkohshme para se të aplikosh.

Nëse përmbush kushtet e nevojshme mund të aplikosh nga data 1 Qershor deri më 15 Gusht 2020.

Udhëzimet për aplikimin:

1. Para se të paraqisësh kërkesën, duhet të **paguash 130,00 €** përmes modelit **F24** (RECT 2020), d.m.th., kostoja e procedurës. Mund të paguash formularin F24 në postë dhe në bankë, ose online në faqen e internet të [Agjencisë së të Ardhurave](#) (*Agenzia delle Entrate*).
2. Kërkesën duhet ta nisësh nëpërmjet një sporteli të vecantë të quajtur ***sportello amico*** të Postës. Kërko tek ky sportel *kit*-in që përmban modulet që duhen plotësuar dhe firmosur. Në formularin e plotësuar duhet të bashkëngjitesh edhe:
 - një kopje të pashaportës ose certifikatë identiteti;
 - dokumente që tregojnë se ke punuar para 31 Tetorit 2019 në një nga tre sektorët që përfshin sanatoria.Kjo procedurë kushton **30 €**, të cilat do të duhet ti paguash shtesë.
Kujdes: nga 1 deri në 10 Qershor, sporteli i vecantë i Postës *sportello amico* që ndjek këtë procedurë do të shërbejë në rend alfabetik. Këtu është [kalendari me rend alfabetik](#). Kjo do të thotë që mund të aplikosh vetëm ditën kur posta pranon njerëzit me shkronjën e parë të mbiemrit si tënden. **Pas 10 Qershorit** (deri më 15 Gusht) mund të shkosh në çfarëdolloj dite që preferon. Kontrolllo me kujdes oraret e *sportello amico* më prane teje.
3. Në momentin që nis kërkesën, sporteli i Postës *sportello amico* do të japë:
 - një letër me datën e **takimit** në Kuesturë (Questura) (për fotot dhe identifikimin). Duhet të shkosh në Kuesturë në ditën dhe kohën e caktuar.
 - **vërtetimin** për dërgimin e kërkesës. Ky vërtetim do të lejojë të qëndrosh në Itali në mënyrë të ligjshme dhe të punosh në territorin italian në një nga tre sektorët e lartpërmëndur.
4. Pasi Kuestura të ketë shqyrtuar kërkesën tënde, nëse rezultati është pozitiv, **do të marësh lejen e përkohshme**.
5. Nëse në gjashtë muajt e lejes së përkohshme do të gjesh punë të rregullt në njërin nga tre sektorët, pra me kontratë, **mund të konvertosh lejen e qëndrimit** nga të përkohshme në leje qëndrimi për motive pune (*permesso di soggiorno per motivi di lavoro*). Kërkesa për konvertim duhet të bëhet gjithmonë nëpërmjet sportelit të Postës *sportello amico*.

Gjatë kohës së nevojshme për verifikim, **personi i huaj nuk mund të dëbohet** përveç për arsye serioze.

KUJDES: Bëj shumë kujdes me informacionit që gjen në mediat sociale apo Whatsapp. Këto janë rregullat e vetme të komunikuar për të aplikuar. Mos u beso njerëzve që të kërkojnë para për të siguruar një kontratë pune.

Nëse ke nevojë për më shumë informacion, ke dyshime ose vëren diçka të çuditshme në procesin e aplikimit, kontakto shoqatat që merren me të drejtat e të huajve në qytetin ku ndodhesh ose sindikatat.

2. PUNËDHËNËSI QË DO TË LEGALIZOJË PUNONJËSIT

Punëdhënësi mund të bëjë kërkesë për legalizimin e një marrëdhënie pune të parregullt (punë pa kontratë ose "në të zezë") për një shtetas italian ose të huaj. Kështu, punëtori pajiset me një kontratë të rregullt pune.

Falë kontratës së rregullt, punëtori i huaj **mund të marrë leje qëndrimi (permesso di soggiorno) për arsye pune**.

Mund të aplikohet vetëm nëse:

- Marrëdhënia e punës është në vazhdim e sipër;
- Punëtori i huaj ka qenë në Itali që para 8 Marsit 2020 (dhe mund ta provojë atë me gjurmët e gishtërinjve ose deklarimin e pranisë). Gjithashtu, nuk duhet të jetë larguar nga Italia që nga ajo datë.

Si të aplikosh

Aplikimi mund të bëhet **VETEM online nga data 1 Qershor deri me 15 Gusht 2020**.

Udhëzimet për aplikimin:

1. Para dërgimit të kërkesës, punëdhënësi duhet **të paguajë një kontribut prej 500,00 €** për secilin punëtor, duke përdorur modelin **F24** (REDT 2020). Formulari F24 mund të paguhet në postë dhe në bankë, ose online në faqen e internetit të **Agjencisë së të Ardhurave** (*Agenzia delle Entrate*).
2. Nga data 1 Qershor deri më 15 Gusht nga ora 7:00 deri ne 22:00 punëdhënësi mund të aplikojë nëpërmjet portalit në këtë faqe **<https://nullaostalavoro.dlci.interno.it/>**. Për të hyrë në këtë faqe duhet të jesh i pajisur me kredencialet SPID (*Sistema Pubblico di Identità Digitale*). SPID mund të kërkohet në **këtë faqe**.
Ja një vidjo **tutorial** për të ndihmuar gjatë aplikimit.
3. Pas dërgimit të kërkesës, në zonën personale të portalit, punëdhënësi mund të **shkarkojë vërtetimin** për aplikimin e sapo bër dhe **duhet t'i japë një kopje punëtorit**.
4. Pas ekzaminimit të kërkesës, organi përkatës i **Sportello unico per l'immigrazione do të kontaktojë punëdhënësin dhe punëtorin** për të paraqitur dokumenta të tjera shtesë dhe, nëse kërkesa pranohet, të firmosin kontratën e punës.
5. Punëtori do të marrë *kit*-it për kërkesën e leje qëndrimit me të dhënat e plotësuar nga Sportello unico. Më pasë **duhet të nisë kit-in për në Kuesturë** (*Questura*) nëpërmjet Postës (tek sporteli **[sportello amico](#)**).

Punëdhënësit mund të marrin ndihmë falas për të plotësuar dhe dërguar kërkesën nga sindikatat, patronatet dhe shoqatat e ndryshme që kanë në fokus punën.

KUR NUK DO TË PRANOHET KËRKESA

Kurë puntori i huaj:

- Ka marrë espuls (dëbim) nga Italia për rrezik shoqëror, terrorizëm ose arsye të tjera serioze. Ndërsa, nëse është dëbuar pasi ka hyrë dhe qëndruar në mënyrë të parregullt në Itali, ka të drejtë të aplikojë.
- Është dënuar (edhe pa dënimin përfundimtar) për veprat penale të drogës, për ndihmën e të huajve për të mbërritur në mënyrë të paligjshme në Itali apo për të shkuar nga Italia në vende të tjera.

Punëdhënësi është dënuar në 5 vitet e fundit (edhe pa një aktgjykim të formës së prerë) për:

- Të ketë ndihmuar në menyrë të paligjshme të huaj për të hyrë dhe qëndruar në Itali ose italianë apo të huaj për të shkuar ilegalisht nga Italia në vende të tjera.
- Prostitucion, shfrytëzim të të miturve dhe të personave.

Këto janë rregullat e përgjithshme për legalizimin (*sanatoria*), por mund të ketë rregulla të ndryshme e specifike bazuar në situatën e vecantë të punës që mund të gjëndesh.

Gjithësesi këshillojmë që është e mira që të kunsultohesh gjithmonë me një avokat nëse mundesh, një sindikatë ose shoqata që mund të ndihmojnë gjatë aplikimit dhe verifikimit të përmbushjes së kërkesave.

Nëse ke nevojë për më shumë informacion, mund të kontaktosh sindikatat (*sindacati*) në qytetin ku ndodhesh ose shoqatat që merren me të drejtat e të huajve.

Ja disa sindikata:

[CGIL](#) - në këtë faqe mund të gjesh kontaktet e zyrës CGIL në qytetin ku jeton.

[CISL](#) - në këtë faqe mund të gjesh kontaktet e zyrës CISL në qytetin ku jeton.

[UIL](#) - në këtë faqe mund të gjesh kontaktet e zyrës UIL në qytetin ku jeton.

Dhe shoqata:

[Siamo qui - sanatoria subito' network](#) - sportele për mbështetje juridike në të gjithë Italinë. Për ndihmë mund të shkosh tek sporteli në qytetin tënd.

[Progetto Diritti onlus](#) - (Pjojekti për të Drejtat onlus) i cili merret me të drejtat e të huajve aktualisht me zyra në Romë, Ostia, Terracina dhe në Siçili (Catania dhe Licata).

Në [këtë faqe](#), mund të gjesh informacionet më të fundit mbi masat shëndetësore, ekonomike dhe ndihma të aktivuara në Itali, të përkthyer në shumë gjuhë.